



© E drejta e autorit 2023, Administrata e Burimeve Njerëzore të Nju-Jorkut/
Departamenti i Shërbimeve Sociale. Për të marrë leje lidhur me shumëfishimin
e të gjithë këtij materiali ose të një pjese të tij, kontaktoni Administratën e
Burimeve Njerëzore të Nju-Jorkut.



Mirëqenia, Vlerësimi
Gjithëpërfshirës, Rehabilitimi
dhe Punësimi

BRC-1065 (AL)

Misioni ynë

WeCARE është krijuar që t'ju ofrojë shërbime, pavarësisht nivelit të aftësisë suaj. WeCARE është konceptuar si program që t'ju ndihmojë të përmbushni potencialin tuaj. Mirëqenia juaj është shqetësimi ynë më i madh dhe ne duam t'ju ndihmojmë që të arrini qëllimet tuaja. Shërbimet e personalizuar e bëjnë WeCARE unik.

Çfarë të prisni

WeCARE do të vlerësojë gjendjen tuaj mjekësore dhe do t'ju ofrojë shërbimet që ju nevojiten për të përmbushur potencialin tuaj. WeCARE ju ofron me një larmi shërbimesh, duke filluar nga referimet mjekësore, deri te punësimi e trajnimi në vendin e punës, bazuar tek interesat dhe aftësitë tuaja.



5 hapa për mirëqenie më të përmirësuar

1

Ju do të merrni një vlerësim për të identifikuar çështje mjekësore ose çështje të tjera që mund të ndikojnë në aftësinë tuaj për të marrë pjesë në aktivitetet e lidhura me punën.

2

Bazuar te vlerësimi gjithëpërfshirës, ne do të punojmë me ju për të hartuar një plan të personalizuar për të përmbushur nevojat tuaja.

3

Në varësi të planit tuaj, mund:

- » Të merrni trajtim për të përmirësuar gjendjen tuaj shëndetësore dhe për të përparuar drejt mirëqenies;
- » T'ju ofrohen shërbime të specializuara punësimi, duke përfshirë një mjedis pune që u përshtatet kufizimeve tuaja;
- » Të merrni ndihmë për të aplikuar për përfitimet e invaliditetit, për të cilat mund të jeni i përshtatshëm.

4

Për t'ju ndihmuar që të jeni të suksesshëm, ne do të punojmë me ju për të monitoruar ecurinë tuaj.

5

Pasi të gjeni një punë, ne do të sigurohemi që të merrni mbështetjen që ju nevojitet për ta mbajtur atë, duke ju ofruar vazhdimisht ndihmë që të përmbushni potencialin tuaj.

Shërbimet e disponueshme që ju ndihmojnë të keni sukses

- Lidhja me kujdesin mjekësor
- Menaxhimi i rasteve
- Referimet për ndihmë me problemet ligjore
- Ndihmë me problemet familjare dhe kujdesin për fëmijët
- Përmirësimi i aftësive në gjuhën angleze
- Trajnim për aftësitë për punë
- Arsimi
- Veprimtari të specializuara pune
- Përgatitja e CV-së
- Shërbimet e punësimit
- Shërbimet e stafit
- Ndihmë me aplikimin për përfitimet e invaliditetit (si p.sh. SSI, SSDI)